VENDIM
Nr. 80, datë 30.6.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT, MODIFIKIMIT, TRANSFERIMIT TË PJESSHËM OSE TË PLOTË, RINOVIMIT DHE HEQJES SË LICENCAVE", NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 26 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit, heqjes dhe rinovimit të licencave në sektorin e energjisë elektrike" dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjes dhe rinovimit të licencave", në sektorin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjes dhe rinovimit të licencave", në sektorin e energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti